

20140381093

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E LIGJIT PËR MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13 dhe 164/13), në nenin 97 pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7), si vijojnë:

"(6) Tregtari me antikitete, sende artistike ose sende tjera të koleksioneve dhe personat tjerë fizikë dhe juridikë që kryejnë shitje të antikiteteve, sendeve artistike ose sende tjera të koleksioneve nga paragrafi (5) i këtij neni, janë të obliguar që për të mirat nga paragrafi (5) i këtij neni, që janë lëndë e shitjes ta sigurojnë certifikatën nga paragrafi (5) i këtij neni.

(7) Gjatë shitjes së të mirave nga paragrafi (5) i këtij neni, tregtari me antikitete, sende artistike ose sende tjera të koleksioneve nga paragrafi (6) i këtij neni, është i obliguar që blerësit t'ia japë certifikatën nga paragrafi (5) i këtij neni dhe ta informojë blerësin se të mirat nga paragrafi (5) i këtij neni mund të eksportohen jashtë vendit vetëm në bazë të certifikatës nga paragrafi (5) i këtij neni."

Paragrafët (6), (7), (8) dhe (9) bëhen paragrafë (8), (9), (10) dhe (11).

Neni 2

Në nenin 172 paragrafi (1) pas pikës 13 shtohet pikë e re 14, si vijon:

"14) lëshon në shitje antikitete, sende artistike ose sende tjera të koleksioneve që nuk kanë status të të mirave të mbrojtura sipas dispozitave të këtij ligji, pa siguruar paraprakisht certifikatë nga Drejtoria (neni 97 paragrafi (6));".

Pikat 14, 15, 16 dhe 17 bëhen pika 15, 16, 17 dhe 18.

Në paragrafët (3) numrat "1, 2, 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17" zëvendësohen me numrat "1, 2, 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18".

Në paragrafin (4) numrat "2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17" zëvendësohen me numrat "2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18".

Në paragrafin (7) numrat "1, 3, 4, 6, 7, 8 dhe 14" zëvendësohen me numrat "1, 3, 4, 6, 7, 8, 14 dhe 15".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".